



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN / MUNICIPALITY OF LIPJAN



Drejtoria i Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Datë/Datum/ Date:	05.01.2026
Për/Za/For:	z. Imri Ahmeti – Kryetar i Komunës së Lipjanit
CC:	z. Diamant Bytyqi – Nënkyetar i Komunës z. Avni Jashari - Shef i Kabinetit të Kryetarit
Nga/Od/From	z. Rexhep Rexhepi - Drejtori i Drejtoratit për Bujqësi dhe Pylltari
Lënda/Subjecat/Subject:	Raporti për muajin Dhjetor

I nderuar Kryetar Z. Imri Ahmeti,

Të bashkangjitur gjeni Raportin mujor të aktiviteteve të Drejtoratit të Bujqësisë për periudhën nga 01.12.2025 deri me 31.12.2025

Lipjan 2025

PËRMBLEDHJE E PERGJITHSHME E RAPORTIMIT

SEKTORI I BUJQËSIË

Gjatë muajit Dhjetor, Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural ka vazhduar me zbatimin e projekteve dhe aktiviteteve të planifikuara për këtë periudhë, duke u fokusuar në përmirësimin e kushteve të punës dhe ofrimin e shërbimeve sa më efikase për qytetarët.

Komisioni në kuadër të Drejtorisë ka bërë publikimin zyrtar të listave të përfituesve për mbështetje me mekanizëm bujqësor.

Gjatë muajit Dhjetor është realizuar shpërndarja e mekanizmit bujqësor për përfituesit, në një ceremoni zyrtare ku ishte i pranishëm edhe Kryetari i Komunës, z. Imri Ahmeti. Janë shpërndarë pajisje si freza, spërkatëse dhe shpërndarëse të plehut mineral, duke kontribuar drejtpërdrejt në rritjen e kapaciteteve prodhuese të fermerëve.

Në koordinim me organizatën QATAR Charity, është realizuar dalja në terren për pranimin dhe verifikimin e të gjitha serrave të montuara. Janë përfunduar vizitat në të gjitha lokalitetet përkatëse, me fokus në monitorimin e gjendjes së serrave dhe bashkëbisedimin me përfituesit lidhur me funksionalitetin dhe nevojat e tyre.

Janë trajtuar dhe sistemuar të gjitha kërkesat e pranuar në Drejtorinë e Bujqësisë gjatë gjithë vitit 2025, duke siguruar administrim të rregullt dhe transparent të dokumentacionit.

Janë mbajtur takime pune me organizatat IADK dhe QATAR Charity, me qëllim shqyrtimin e mundësive për bashkëpunim dhe zhvillimin e projekteve të reja në sektorin e bujqësisë për vitin 2026, duke marrë parasysh edhe kapacitetet tona buxhetore.

Komisioni nga Drejtoria e bujqësisë dalur në teren për të realizuar vlerësimin e dëmeve të ndryshme të shkaktuara nga faktorë të ndryshëm, me qëllim evidentimin dhe trajtimin e tyre institucional.

Operatori për trajtimin e qenëve endacak ka vazhduar me intervenime sipas kërkesave të qytetarëve në lagje të ndryshme të Komunës së Lipjanit. Këto veprime kanë për qëllim përmirësimin e sigurisë publike dhe krijimin e një ambienti më të qetë për qytetarët tanë.

Në kuadër të përmirësimit të kushteve të qasjes në zonat bujqësore, është realizuar zhavorrimi i rrugës në fshatin Hanrovc. Ky projekt ka filluar gjatë muajit nëntor dhe ka përfunduar në muajin dhjetor. Ky investim do të lehtësojë qarkullimin e mjeteve bujqësore dhe transportin e produkteve, duke kontribuar në zhvillimin ekonomik të kësaj zone.